

VENDIM
Nr. 220, datë 23.4.2014

**PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE
NGA MINISTRIA E KULTURËS TE KOMITETI SHTETËROR I MINORITETEVE
DHE AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve në katin e tretë të godinës së ish-shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës, të Komiteti Shtetëror i Minoriteteve dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për t’u përdorur si mjedise pune nga këto institucione, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Këtyre institucioneve u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen ministri i Kulturës, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe kryeregjistruesi i Zyrës për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TRETË SHK. 1:100

MINISTRIA E NDERTIMIT INSTITUTI SATELITOR I PROJEKTIMIT DEGA E ARKITEKTURËS		MARKA A	Nr. FLETËS 3	SIP. Ark.
INVESTITORI MINISTRIA E ARSIMIT			FAZA: Pr. 1b.	
OBJEKTI SHËNDSHKRONJE E RE "ORANI"			AUTOR KRYES S. MOJAKO	
TITULLI I VIZATIMIT PLANI KATIT , DITË, TRETË 1:100			BASHEAUTOR S. MOJAKO	
DATA			M. SANO	
DREJTORI S. ANGONI			NDIKTROR R. FAJA	
			PERPUNOR G. RYDARI	
			VIZATOR S. DUKA	
			TEKNOLOG	
			KONTROLLI TEKNIK	



PLANI KAITI DYĚ ME TĚ IREI E IREIÉ SHK 1-100

[illegible]

